

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8028
E premte, 4 prill 2025
Çmimi 0.50 €

Dialogu Kosovë - Serbi ka ngecur, po shqyrtohen mjete të tjera për normalizim



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DY JAVË KOHË PËR NJË 'QEVERI TË BRISHTË'



Dy javët e mbetura deri të mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës janë të mjaftueshme që Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve parlamentare të 9

shkurtit, të zhvillojë bisedime me subjektet e tjera politike për konstituimin e legjislativit dhe për formimin e qeverisë së re. Kështu vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike

nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. Por, ata paralajmërojnë se koalicioni qeverisës mund të rezultojë "i brishtë"

AKTUALE



TARIFAT E SHBA-SË NXISIN REAGIME NË BOTË F. 2

JAVËN E ARDHSHME KONJUFCA Mbledh krerët e partive në takim F. 3

OSMANI DO TA PËRFAQËSOJË KOSOVËN NË TAKIMIN E PROCESIT AQABA PËR BALLKANIN III NË SOFJE F. 3


EKONOMI



TRUMPI SHPALL TARIFA RECIPROKE NDAJ TË GJITHA VENDEVE, PËRFSHIRË KOSOVËN F. 8

GËRHXHALIU: QËNDRIMET E FMN-SË DHE REALITETI EKONOMIK NË KOSOVË NUK PËRPUTHEN F. 8

SPORT



KOSOVA MORI PJESË NË KONGRESIN E UEFA-S NË BEOGRAD ME SIMBOLE SHITËTËRORE F. 10

GJYKIMI I ISH-KRERËVE TË UÇK-së, SPECIALJA: PROKURORIA KA PËRFUNDUAR PARAQITJEN E PROVAVE, RASTI NUK ËSHTË PËRMBYLLUR F. 4-5



ARSIM BAJRAMI: UROJ TË KEMI QEVERI SA MË GJITHËPËRFSHIRËSE, JEMI NË ÇASTE HISTORIKE F. 6



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tarifat e ShBA-së nxisin reagime në botë



BRUKSEL, 3 PRILL - Vendimi i presidentit amerikan Donald Trump për të vendosur tarifa reciproke ndaj të gjitha vendeve ka nxitur reagime në mbarë botën, por shtetet kanë shprehur frikën për rritjen e çmimeve e disa vende kanë paralajmëruar kundërmasa. ShBA-ja vendosi një tarifë bazë prej 10-përqindësh për importet ndaj të gjitha vendeve të botës, përfshirë nga Kosova, si dhe tarifa më të larta për dhjetëra vende që kanë suficit tregtar me ShBA-në. Bashkimi Evropian reagoi ndaj vendimit të Trumpit, duke thënë se është i gatshëm të përgjigjet ndaj tarifave të reja amerikane. Por, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, i bëri thirrje presidentit amerikan t'i adresojë shqetësimet përmes dialogut. "Më vjen keq për këtë zgjedhje", tha von der Leyen. "Duket se nuk ka asnjë rregull në këtë kaos. Asnjë rrugë e qartë përmes kompleksitetit dhe kaosit që po krijohet, teksa të gjithë partnerët tregtarë të ShBA-së po goditen". Ajo shtoi se BE-ja është "e gatshme të përgjigjet". "Ne tani po përgatitemi për kundërmasa të mëtejme për t'i mbrojtur interesat tona dhe bizneset tona nëse negociatat dështojnë", tha ajo. BE-ja u godit me 20 për qind tarifa nga ShBA-ja. Paraprakisht Trumpi kishte vendosur tarifa ndaj importeve të çelikut dhe aluminit të BE-së, por edhe automjeteve dhe pjesëve për automjete. Blloku, megjithatë, ka kërkuar

t'i zgjidhë shqetësimet tregtare të Trumpit përmes dialogut dhe von der Leyen sërish më 3 prill e la të hapur derën e dialogut. "Ka një rrugë alternative. Nuk është vonë për t'i adresuar këto shqetësimet përmes negociatave", tha ajo. Sipas zyrtarëve të lartë evropiane, tarifave e reja do t'i prekën konsumatorët në mbarë botën. "Do të ndihet menjëherë. Miliona qytetarë do të përballen me çmime më të larta të produkteve ushqimore. Ilaçet do të kushtojnë më shumë, sikurse edhe transporti. Inflacioni do të rritet", paralajmëroi ajo. Për shkak të vendimit të Trumpit, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, do të takohet të enjten me përfaqësuesit e sektorëve francezë "të prekur nga tarifave amerikane, bëri me dije Pallati Elize. Tarifave kanë prekur edhe Mbretërinë e Bashkuar, aleatin e Uashingtonit. Londra tha se shpreson të arrijë një marrëveshje tregtare me Uashingtonin. Por, sekretari për biznesin e Mbretërisë së Bashkuar, Jonathan Reynolds, paralajmëroi se shteti i tij ka "një sërë mjeteve në dispozicion dhe ne nuk do të hezitojmë të veprojmë". Italia, ndërkaq, kritikoi vendimin amerikan për tarifa, duke i kërkuar BE-së të arrijë një marrëveshje, pasi tha se një luftë tregtare "do ta dobësonte Perëndimin". "Vendosja e tarifave nga ShBA-ja ndaj BE-së është një masë që unë e vlerësoj të gabuar dhe

nuk është në interesin e asnjërës palë", tha kryeministria italiane Giorgia Meloni. Shoqata gjermane e Industrisë së Automobilitave, po ashtu, i ka kritikuar tarifave, duke thënë se do të krijojnë "vetëm humbje". Ndërkaq, industria gjermane e kimikateve, që e ka ShBA-në tregun më të madh të eksporteve, kërkoi qetësi, duke theksuar se "një përshkallëzim vetëm se do ta përkeqësonte dëmin". Kina, po ashtu, u zotua për "kundërshtim të fuqishëm" të tarifave amerikane ndaj eksporteve të saj dhe tha se do të ndërmarrë "kundërmasa për t'i ruajtur të drejtat dhe interesat tona". Ministria kineze e Tregtisë tha se tarifave e reja amerikane "nuk janë në përputhje me rregullat ndërkombëtare të tregtisë dhe seriozisht dëmtojnë të drejtat legjitime dhe interesat e palëve të rëndësishme". Pekini, që u godit me një tarifë prej 34-përqindësh, i bëri thirrje Uashingtonit "ta shfuqizojë menjëherë" vendimin për tarifave, duke paralajmëruar se ato "vënë në rrezik zhvillimin ekonomik global" dhe dëmtojnë interesat amerikane dhe zinxhirët ndërkombëtarë të furnizimeve. Kanadaja, shtet fqinj i ShBA-së, tha se tarifave amerikane do ta "ndryshojnë krejtësisht sistemin tregtar botëror". "Ne do t'i kundërvihemi këtyre tarifave me kundërmasa. Ne do t'i mbrojmë punëtorët tanë", tha kryeministri Mark Carney, i cili edhe më herët është zotuar

se do t'i përgjigjet ShBA-së ndaj tarifave të mëhershme nga Uashingtoni. Japonia, ndërkaq, tha se vendimi i Trumpit "është për keqardhje", duke shtuar se tarifave e reja mund ta zhbëjnë marrëveshjen tregtare që kanë dy shtetet. Firmat japoneze janë investitorët më të mëdha në ShBA, por Tokio ka dështuar që të përjashtohet nga vendimi i Trumpit për tarifa, teksa Japonia u godit me 24 për qind tarifë. "E kam përcjell mesazhin se tarifave e vendosura nga ShBA-ja janë për keqardhje, dhe sërish i bëj thirrje Uashingtonit të mos i aplikojë këto masa ndaj Japonisë", tha ministri për Tregti dhe Industri i Japonisë, Yoji Muto. Ai shtoi se ka folur me sekretarin amerikan të Tregtisë, Howard Lutnick, para se Trumpi të vendoste tarifa ndaj shteteve, përfshirë edhe ndaj shtetit aleat, Japonisë. Ministri japonez tha se i ka shpjeguar Lutnickut se si tarifave amerikane do të ndikojnë në ekonominë e ShBA-së "duke minuar kapacitetin e kompanive japoneze për të investuar". Ndërkaq, një zëdhënës i qeverisë japoneze tha se masat e ShBA-së mund të mos jenë në përputhje me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Tajvani, ndërkaq, i ka cilësuar "të paarsyeshme" tarifave e ShBA-së, duke thënë se qeveria në Taipei synon të zhvillojë negociatat me Uashingtonin.

Ishulli vetëqeverisës i Tajvanit, përveç me tarifën bazë, është goditur me 32 për qind tarifë. Çipat gjysmëpërcues, sektor ku Tajvani dominon dhe që kanë qenë burim tensionesh në mes të Uashingtonit dhe Taipei, janë përjashtuar nga tarifave. Megjithatë, analistët kanë paralajmëruar se tarifave ndaj komponentëve të tjerë do të kenë ndikim edhe në industrinë e çipave. Tajvani më 2024 kishte suficit tregtar me ShBA-në në vlerë prej 73.9 miliardë dollarësh, duke e bërë atë vendin e shtatë me suficitin më të lartë tregtar. Për t'u mbrojtur nga ndikimi i tarifave amerikane, Tajlanda tha se ka "një plan të fuqishëm", por nga qeveria tajlandeze thanë se shpresojnë të negociojnë me Uashingtonin për uljen e tarifave. Shtetet në Azinë Juglindore kanë nivel të lartë të suficitit tregtar me ShBA-në dhe janë goditur me tarifa të larta nga Uashingtoni. Më 2 prill presidenti amerikan Donald Trump shpalli emergjencë ekonomike kombëtare për t'i zbatuar tarifave, të cilat pritet të prodhojnë qindra miliarda dollarë të ardhura vjetore. Ai ka premtuar se vendet e punës në fabrika do të kthehen në ShBA si rrjedhojë e këtyre tarifave, por politikat e tij rrezikojnë ngadalësim të papritur ekonomik pasi konsumatorët dhe bizneset mund të përballen me rritje të mëdha të çmimeve për automjetet, rrobat dhe mallra të tjera.

Kurti dhe ambasadori suedez flasin për investimet dhe aktualitetin politik

Prishtinë, 3 prill - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund. Siç njofton qeveria, së bashku ata kanë diskutuar për mënyrat e thellimit dhe fuqizimit të mëtejme të marrëdhënieve bilaterale dhe zgjerimin e bashkëpunimit. "Mbi këtë të fundit në fokus të diskutimit ishte ai me Odën

Ekonomike Nordike dhe tërheqjen e investimeve suedeze në Kosovë. Kryeministri Kurti theksoi mundësitë, ofertën dhe potencialin që ofron vendi ynë për investitorë të huaj. Gjithashtu diskutuan mbi aktualitetin politik në vend, gjersa kryeministri ka filluar konsultimet politike me partitë e komuniteteve joshumicë për

formimin e institucioneve të legjislaturës së 9-të, pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve të 9 shkurtit", ka njoftuar qeveria. Kryeministri Kurti e ka falënderuar ambasadorin Westerlund për mbështetjen e vazhdueshme të Suedisë dhënë Kosovës dhe për marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve.



GJYKIMI I ISH-KRERËVE TË UÇK-SË, SPECIALJA: PROKURORIA KA PËRFUNDUAR PARAQITJEN E PROVAVE, RASTI NUK ËSHTË PËRMBYLLUR

HAGË, 3 PRILL - Zëdhënësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë kanë mbajtur një konferencë për medie për të raportuar mbi zhvillimet e procesit ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ku ishin të pranishëm gazetarë nga Prishtina. Ata informuan se Prokuroria ka përfunduar zyrtarisht paraqitjen e provave në gjykatë, por nuk e ka mbyllur ende rastin. Sipas tyre, seanca e ardhshme është caktuar për 23 prill. Zëdhënësjja e Gjykatës Speciale, Angela Greip, ka thënë se në gjykatë kanë dëshmuar 125 dëshmitarë, kurse 117 me shkrim. "Nga ajo që dimë është se Prokuroria ka konfirmuar se kanë përfunduar paraqitjet e provave, por nuk e ka mbyllur

rastin zyrtarisht. Seanca e radhës është caktuar më 23 prill. Prokuroria deri atëherë do ta përfundojë rastin. 125 dëshmitarë kanë qenë, dhe 117 kanë dëshmuar vetëm me shkrim. 206 ditë të gjyqimit dhe 150 viktima", tha ajo. Griep shtoi se gjyqtarët e Dhomave të Specializuara sigurojnë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke nënvizuar se ata janë të angazhuar për të zbatuar një kod etik. Ndërsa zëdhënësi tjetër, Michael Doyle, u shpreh se qytetarët e Kosovës duhet të besojnë se Specialja sjell vendime të drejta, dhe se vendimi i gjyqtarëve bazohet vetëm në prova. Ai, gjithashtu, theksoi se është e rëndësishme që viktimat dhe dëshmitarët të



mund të japin dëshmi në një mjedis të sigurt dhe të dinjitetshëm. "Duam nga qytetarët e Kosovës ta kuptojnë rolin e gjykatës për gjykimet të drejta. Por,

gjithashtu, edhe viktimat e dëshmitarët të mund të dëshmojnë të lirë. Viktimat të mund të marrin pjesë me dinjitet. Është e rëndësishme që gjykata merret me krimet

individuale. Prokuroria mund t'i vërtetojë vetëm krimet individuale. Është e rëndësishme të thuhet se viktimat janë nga etni të ndryshme", tha Doyle.

OSMANI PËRFAQËSON KOSOVËN NË TAKIMIN E PROCESIT AQABA PËR BALLKANIN III NË SOFJE



Prishtinë, 3 prill - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, me ftesë të Mbretit të Jordanisë, Abdullah II dhe presidentit të Bullgarisë, Rumen Radev, ka udhëtuar për në Bullgari, për ta përfaqësuar Republikën e Kosovës krahas liderëve të tjerë në takim dhe nivelit të lartë të Procesit Aqaba për Ballkanin III, i cili do të mbahet në Sofje. Në kuadër të vizitës në Sofje, presidentja Osmani do të mbajë fjalim në hapje të Samitit si dhe do të zhvillojë takime të ndara bilaterale me disa nga liderët pjesëmarrës.

Gjatë këtyre takimeve do të diskutohet thellimi i marrëdhënieve bilaterale, avancimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe forcimi i përpjekjeve të përbashkëta për stabilitetin rajonal. Ky takim organizohet nën përkujdesjen e Mbretërisë Hashemite të Jordanisë dhe Republikës së Bullgarisë dhe synon ta forcojë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit. Procesi Aqaba, i iniciuar nga Mbreti Abdullah II i Jordanisë

në vitin 2015, ka luajtur rol kyç në koordinimin e përpjekjeve globale kundër terrorizmit dhe adresimin e sfidave të sigurisë. Presidentja Osmani do ta theksojë angazhimin e suksesshëm të Kosovës në luftën kundër terrorizmit dhe radikalizmit, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me aleatët dhe partnerët strategjikë. Në këtë kuadër ajo do ta riafirmojë përkushtimin e Kosovës për sigurinë rajonale dhe për forcimin e kapaciteteve të institucioneve të saj të sigurisë në përputhje me standardet euroatlantike.

Javën e ardhshme Konjufca mbledh krerët e partive në takim

Prishtinë, 3 prill - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në javën e ardhshme do t'i presë në takim krerët e partive

politike. Sipas burimeve të gazetës, takimi pritet të ndodhë të martën, më 8 prill, me fillim nga ora 12:00. Kjo mbledhje

mbahet për organizimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, që është caktuar më 15 prill. E presidentja e Kosovës,

Vjosa Osmani, ka thirrur seancën konstituive të legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Kosovës për datën 15 prill 2025.





DY JAVË KOHË PËR NJË 'QEVERI TË BRISHTË'

Prishtinë, 3 prill - Rreth dy javët e mbetura deri te mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës janë të mjaftueshme që Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, të zhvillojë bisedime me subjektet e tjera politike për konstituimin e legjislativit dhe për formimin e qeverisë së re. Kështu vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike. Por, ata paralajmërojnë se koalicioni qeverisës mund të rezultojë "i brishtë". "Besoj që [dy javë] është hapësirë e nevojshme kohe që të zhvillohen diskutime, të paktën për çështjen e kuvendit", thekson Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës.

Besar Gërgi, hulumtues në Grupin për Studime Ligjore dhe Politike, nuk e cilëson kohën prej dy javësh afat problematik për arritjen e pajtimit për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë së re të Kosovës. "Është problem vullneti politik [i subjekteve politike] dhe pjekurisë politike të tyre", thekson Gërgi për "Radion Evropa e Lirë". Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, të martën thirri

mbledhjen për konstituimin e Kuvendit të Kosovës që do të mbahet më 15 prill. Një ditë më pas, ajo tha se deri atëherë "ka kohë të mjaftueshme" për përgatitjet teknike për konstituimin e Kuvendit të Kosovës.

Konstituimit të plotë të kuvendit i paraprinë zgjedhja e kryetarit të saj dhe nënkryetarëve, me shumicën e votave të deputetëve.

Kryetari i kuvendit duhet të propozohet nga Lëvizja Vetëvendosje.

Lëvizja Vetëvendosje, si parti fituese, në zgjedhjet e 9 shkurtit ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, por ato nuk mjaftojnë për votimin e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, si dhe për formimin e qeverisë, që kërkon të paktën 61 vota.

Sa iu përket koalicioneve, LV-ja ka thënë se pëlqen ta formojë ekzekutivin me disa nga partitë e komuniteteve joshumicë - të cilat kanë 20 ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Komunitetet pakicë joserbe kanë dhjetë ulëse, ndërsa Lista Serbe ka fituar nëntë nga dhjetë ulëset që i takojnë komunitetit serb.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, njëherësh kryetar i

Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të mërkurën ka nisur takimet me parti politike të pakicave, për t'u konsultuar rreth formimit të qeverisë së re të vendit. Ai është takuar me kryetaren e Partisë së Re Demokratike (NDS) nga komuniteti boshnjak, njëherësh zëvendëskryeministre në detyrë, Emilija Rexhepi, me kryetarin e Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë nga komuniteti serb, Nenad Rashiç, dhe kryetarin e partisë Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), Elbert Krasniqi. Gjatë së enjtes, Kurti ka vazhduar takimet me përfaqësues të tjerë të partive joserbe.

Më 30 mars ai paralajmëroi mundësinë që Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës të formohen brenda një dite.

Pajtimi i mundshëm për krijimin e qeverisë së re

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës thotë se para se 15 prilli të caktohet si datë për seancën konstituive të Kuvendit, partitë politike kanë pasur më shumë se një muaj kohë për të biseduar për koalicionet eventuale për formimin e qeverisë së re. Sipas tij, ato kanë pasur sinjale të

qarta që rezultati preliminar zgjedhor nuk do të ndryshojë shumë nga rezultati i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 27 mars.

Lëvizja Vetëvendosje deri më tash ka përjashtuar mundësinë e koalicionit me tri subjektet e tjera politike, Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe koalicionin Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate.

Ndryshe nga LDK-ja dhe AAK-ja, të cilat janë shprehur kundër një koalicioni qeverisës me Lëvizjen Vetëvendosje, PDK-ja dhe Nisma Socialdemokrate nuk kanë vendosur "vija të kuqe" për asnjë parti. Për më shumë, Nisma, e cila ka siguruar tri ulëse në Kuvend, ndryshe nga partnerja e saj në koalicion parazgjedhor - AAK-ja me pesë deputetë - ka lënë të kuptohet se iniciativën për koalicionin e mundshëm duhet ta marrë LV-ja.

Cakolli e sheh këtë si mundësi për Lëvizjen Vetëvendosje që bashkë me votat e partive pakicë, të sigurojë 61 vota për formimin e qeverisë së re, menjëherë pas konstituimit të kuvendit.

Me deputetët e Nismës, dhjetë deputetët e pakicave joserbe

dhe Rashiqin, LV-ja do të sigurojë 62 vota në kuvend.

Cakolli thotë se ditët në vijim, deri në seancën konstituive të Kuvendit, janë të mjaftueshme që të sigurohet një pajtim ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputetëve të caktuar nga partitë e tjera. "Ka indikacione që Lëvizja Vetëvendosje mund të shkojë drejt negocimit individual me deputetë të caktuar - përfshirë këtu ata të Nismës dhe, mbase, edhe të tjerë - për ta siguruar atë pragun minimal kushtetues prej 61 votash për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, por edhe për qeverinë e re", thotë Cakolli për "Radion Evropa e Lirë".

Ai shton se në rast se LV-ja arrin t'i sigurojë votat e domosdoshme për votimin e kryetarit të Kuvendit, atëherë konstituimi i këtij institucioni mund të bëhet brenda pak orësh. Në këtë kontekst, ai nuk e sheh të pamundur që po të njëjtën ditë, më 15 prill, të caktohet edhe një seancë në Kuvend për formimin e qeverisë së re, ndonëse procedurat sikurse propozimi i qeverisë së re nga Lëvizja Vetëvendosje, si dhe më pas nominimi i mandatares nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, mund të marrin pak kohë.

DIALOGU KOSOVË - SERBI KA NGE CUR, PO SHQYRTOHEN MJETE TË TJERA PËR NORMALIZIM

PRISHTINË, 3 PRILL - Bashkimi Evropian është i interesuar për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë qoftë përmes dialogut apo ndonjë instrumenti tjetër, ka thënë shefja për Politikë të Jashtme e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". "Ndoshta është dialogu, ndoshta është një tjetër mjet. Jam e gatshme ta shqyrtoj këtë çështje, dhe do ta bëj këtë së bashku me përfaqësuesin e posaçëm [për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen] në ditët në vijim", tha Kallas, e cila pritet ta vizitojë Ballkanin Perëndimor në javën e ardhshme.

Kallas foli, po ashtu, për ndikimin e mundshëm të luftës tregtare në mes të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe për mundësinë e një armëpushimi në Ukrainë, duke theksuar nevojën për përfshirjen e Evropës në çdo negociatë për këtë çështje.

Kanë hyrë në fuqi tarifët e reja [të Shteteve të Bashkuara të Amerikës] prej 25-përqindësh për automjetet. Si do të përgjigjet Bashkimi Evropian dhe çfarë mendoni se tregon kjo për marrëdhëniet transatlantike?

Kaja Kallas: Deri tani njerëzit tanë të tregtisë po bashkëpunojnë me amerikanët, kështu që nuk e dinë saktësisht se çfarë po vjen. Ka deklarata që i shohim, por cilat janë veprimet reale? Nëse vjen një veprim i tillë, edhe ne kemi një plan të gatshëm, por ajo që dua të theksoj është se nuk ka fitues në luftërat tregtare. Në fund, çmimet rriten dhe konsumatorët paguajnë më shumë për këto produkte, dhe ky nuk është veprim i mençur. Prandaj, ende shpresoj që nuk do ta fillojmë këtë luftë tregtare.

[Presidenti i Finlandës], Alexander Stubb, kur ishte në Amerikë së voni, foli për një armëpushim të mundshëm të plotë në luftë [në mes të Ukrainës dhe Rusisë] më 20 prill. A mendoni se është i realizueshëm?

Kaja Kallas: Deri tani Ukraina ka rënë dakord për një armëpushim që para tre javësh, dhe nuk kemi parë asnjë shenjë pozitive nga Rusia. Ata thjesht po luajnë lojëra. Mendoj se do të ishte shumë mirë t'u vihet një afat i



qartë se deri kur duhet të përgjigjen, të tregojnë qëndrimin e tyre dhe të shfaqin vullnet të mirë se duan paqe. Është e qartë që ukrainasit e duan atë.

[Kirill] Dmitriev, një nga negociatorët e Kremlinit, pritet ta vizitojë Uashingtonin së shpejti. A do të dëshironit të flisnit me të? A mendoni se BE-ja duhet të negociojë me të?

Kaja Kallas: Për Ukrainën, Ukraina duhet të negociojë me Rusinë. Kjo nuk mund të bëhet nga askush tjetër, sepse bëhet fjalë për Ukrainën dhe nuk mund të bëhet pa Ukrainën. Mendoj se kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme. Kur bëhet fjalë për sigurinë evropiane, sigurisht që duhet të diskutojmë mes nesh dhe me aleatët tanë për mënyrën se si ta rregullojmë këtë çështje.

Por, a është BE-ja apo ndonjë vend evropian i gatshëm të diskutojë drejtpërdrejt me Moskën?

Kaja Kallas: Kur bëhet fjalë për negociatat reale që lidhen me Evropën, mendoj se është e rëndësishme të kemi parasysh se Rusia nuk duhet të ketë ndikim mbi mënyrën se si ne organizojmë sigurinë tonë, sepse

Evropa nuk po e sulmon Rusinë. Përkundrazi, Rusia ka sulmuar fqinjët e saj, prandaj ne po diskutojmë rreth aranzhimeve tona të sigurisë. Megjithatë, sa i përket negociatave për Ukrainën, është e qartë se Evropa duhet të jetë pjesë e tryezës, sepse rezultati i tyre na prek edhe neve. Dhe, çdo marrëveshje nuk mund të funksionojë pa zbatimin e saj nga ana e evropianëve.

Pra, a do të flisni për këtë me [sekretarin amerikan të Shtetit, Marco] Rubio, kur ai të jetë në Bruksel ditët në vijim?

Kaja Kallas: Ne kemi folur për këtë edhe më parë, kur kishim takimet në kuadër të G7-tës në Kanada, dhe padyshim që do të flasim për këtë sërish. Është shumë e qartë se çfarë ka BE-ja në dorë – sanksionet janë vendosur nga Bashkimi Evropian, kemi misionin e trajnimit për ushtarët ukrainas, misionin civil në Ukrainë dhe gjithashtu procesin e zgjerimit të BE-së, që përfshin Ukrainën.

Javën tjetër do ta vizitoni Ballkanin Perëndimor. Çfarë mendoni për protestat që po shohim aktualisht në Serbi? A jeni të gatshëm të organizoni së shpejti

një takim të nivelit të lartë, në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë?

Kaja Kallas: Sa i përket protestave, kjo është demokracia – ndodh edhe në vendet anëtare të BE-së që njerëzit të lodhen nga qeveritë dhe të protestojnë. Kjo tregon se demokracia po funksionon. Lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, ose dialogun Beograd-Prishtinë, unë kam emëruar një Përfaqësues të Posaçëm, me të cilin do të ulem për të parë të ardhmen. Ajo që na intereson është normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Qoftë përmes këtij dialogu, apo ndonjë instrumenti tjetër, ne do të mbledhim ide dhe do të dalim me një propozim.

Pra, a mund të jetë diçka tjetër, përveç dialogut?

Kaja Kallas: Duket se dialogu ka ngecur pak, sepse palët vetëm po ankohen për njëra-tjetrën. Mendoj se duhet ta mbajmë qëllimin përfundimtar në mendje – normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, në mënyrë që të mund të ecin përpara në rrugën evropiane. Ndoshta është dialogu, ndoshta është një tjetër mjet. Jam e gatshme ta shqyrtoj këtë çështje, dhe do ta bëj këtë së bashku me Përfaqësuesin e

Posaçëm në ditët në vijim.

Dhe, për fund, lidhur me Gjeorgjinë, si i vlerësoni ndryshimet në Ligjin për Agjentët e Huaj dhe Ligjin për Transmetimin? A ka ende BE-ja ndonjë ndikim mbi Gjeorgjinë?

Kaja Kallas: Situata atje është jashtëzakonisht e vështirë. Dimë që shumica e popullit gjeorgjian mbështet fuqimisht Bashkimin Evropian, dhe dëshiron që Gjeorgjia t'i bashkohet BE-së. Por, kjo nuk është rruga që ka zgjedhur qeveria. Pyetja për ne është: çfarë mund të bëjmë realisht për ta ndihmuar? Kemi ridrejtuar fondet nga qeveria tek organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, për t'iu ndihmuar që të vazhdojnë rrugën evropiane.

Por, a ka diçka më konkrete ndaj qeverisë? Sanksionet nuk funksionuan, a ka diçka tjetër?

Kaja Kallas: Ne duhet të kemi marrëveshje në mes të 27 vendeve anëtare. Dhe, ky është problemi këtu. Prandaj, ne ende po punojmë për opsionet që mund të kemi. Kemi vendosur kërkesën për viza për pasaportat diplomatike, por vazhdimisht po diskutojmë se çfarë tjetër mund të bëjmë.

"Shumica e brishtë me koalicionin jostabil"

Edhe Besar Gërgi pajtohet që LV-së i mjaftojnë dy javë për të parë se a mund t'i sigurojë 61 votat e deputetëve për votimin e kryetarit të Kuvendit, konstituimin e këtij institucioni dhe formimin e qeverisë së re. Ai nuk e përjashton mundësinë që kjo shumicë prej 61 votash të sigurohet bashkë me komunitetet joshumicë dhe

deputetë të caktuar nga ndonjë parti tjetër. Por, sipas tij, kjo shumicë në Kuvend do të ishte "e brishtë" ashtu sikurse edhe qeveria e re.

Në kontekstin e zhvillimeve gjeopolitike rajonale dhe globale, sipas tij, Kosovës i nevojitet një qeveri e qëndrueshme, e cila, siç thotë ai, është e pamundur të formohet pa një koalicion ndërmjet LV-së dhe njëres nga dy partitë më të mëdha, PDK-së apo LDK-së. "Në deklaratat publike duhet të gërmojmë shumë thellë

që të gjejmë ndonjë sinjal të dobët se ka ndonjë hapësirë për bashkëpunim, por nuk ka ndonjë deklaratë të qartë, qoftë nga Vetëvendosje, qoftë nga partitë e tjera, lidhur me krijimin e një koalicioni [qeverisë]. Në qoftë se gjenden numrat për formimin e një qeverie, në qoftë se kjo bëhet me numra shumë të brishtë, me një koalicion jostabil, atëherë kjo përsëri nuk i jep siguri Kosovës dhe popullit të saj në këtë situatë shumë të komplikuar gjeopolitike", thekson Gërgi.

Ai shton se një qeveri e siguruar me, siç i quan ai, "numra të brishtë" votash, nuk do të mund ta mbijetojë zgjedhjen e presidentit të Kosovës, që pritet në prillin e vitit të ardhshëm, kur përfundon mandati pesëvjeçar i presidentes Vjosa Osmani. Zgjedhja e një presidenti të ri ose rizgjedhja e Osmanit kërkon shumicën prej 80 votash në Kuvend, në dy raunde. Nëse në dy raundet e para dështon zgjedhja për mungesë të këtij numri të votave, presidenti

zgjidhet me shumicën e thjeshtë prej 61 votash, me kushtin që në seancë të jenë të pranishëm 80 deputetë, që nënkupton dy të tretat nga 120 deputetë sa ka Kuvendi i Kosovës.

Në këtë pikë, sipas Gërgit, të pritshme janë përplasjet në Kuvend ndërmjet partive politike, të cilat mund të mos e krijojnë kuorumin e domosdoshëm. Dështimi i zgjedhjes së presidentit nga Kuvendi e dërgon vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

ARSIM BAJRAMI: UROJ TË KEMI QEVERI SA MË GJITHËPËRFSHIRËSE, JEMI NË ÇASTE HISTORIKE

“Uroj të kemi qeveri sa më gjithëpërfshirëse. Jemi në çaste historike: nëse s’kemi një qeveri për katër vjet, na duhet një qeveri për një vit derisa ta zgjedhim presidentin, dhe kjo qeveri t’i marrë detyrat emergjente e urgjente, të sfidohet me sfidat e kohës dhe, nëse pastaj s’arrihet një konsensus për zgjedhjen e presidentit, vendi të legjitimohet me zgjedhje të reja”, ka thënë anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, profesori universitar Arsim Bajrami



PRISHTINË, 3 PRILL - Anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, profesori universitar Arsim Bajrami, i cili ka qenë pjesë e rrugëtimit të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë që nga vitet '90, porositi që në finalen me Serbinë, Kosova s’bën të bëjë asnjë kompromis më shumë sesa ato që ka bërë kur ka shpallur pavarësinë.

Ai thotë se Asociacioni s’duhet të përdoret politikisht dhe duhet të themelohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këmbim të tij, Bajrami thotë se aleatët, ShBA-ja dhe BE-ja, duhet t’i bëjnë presion Serbisë ta largojë Kosovën nga kushtetuta e saj dhe të mos e luftojë diplomatikisht. Zgjidhja e problemit me Serbinë, Bajrami thekson se është në interes të Kosovës dhe se kjo betejë me fqinjën veriore është politike dhe, si e tillë, duhet fituar. Konflikti, sipas tij, u shkoi për shtati vetëm Serbisë dhe Rusisë, megjë Beogradi dhe Moskë mendojnë se përmes tij mund ta hapin edhe statusin e Kosovës.

Por cili është kompromisi të cilin Kosova s’bën ta bëjë në këtë rrugëtim të vështirë drejt mbylljes së problemit me Serbinë?

Në një intervistë për “Express”, akademiku dhe profesori Arsim Bajrami, i cili ka marrë pjesë në proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova që nga vitet '90, ka thënë se është interes shtetëror dhe kombëtar i Kosovës që ta mbyllë problemin me Serbinë, edhe për shkak të ndryshimeve gjeopolitike dhe faktit që, sipas Bajramit, Kosova “s’mund të llogarisë më në miqtë e vjetër” që kishte në kohën kur e kishte shpallur pavarësinë.

Për profesorin Bajrami, Kosova s’duhet të bëjë asnjë kompromis më shumë përtej atyre që ka bërë me rastin e shpalljes së pavarësisë. “Qeveria e ardhshme që do të formohet duhet ta ketë prioritet parësor që brenda këtij viti ta përmbysë procesin e dialogut, në mënyrë që të hapë një faqe të re të avancimit të Kosovës në proceset euroatlantike. Kur e them këtë, mendoj se Kosova s’duhet të bëjë asnjë kompromis përtej kompromiseve që ka bërë me rastin e shpalljes së pavarësisë”, ka thënë Arsim Bajrami.

Kushti kryesor për të ecur përpara në normalizimin e raporteve me Serbinë është edhe përmbushja e detyrimeve të marra në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, duke nënvizuar rëndësinë e këtij aspekti, i kishte sugjeruar Kosovës ta niste implementimin e njëanshëm të obligimeve pa e pritur fare Serbinë.

Sugjerim për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurtin, rreth përmbushjes së obligimeve të Brukselit, ka pasur edhe profesori Bajrami. Në intervistën për “Express”, ai ka treguar se i ka kërkuar kreut të qeverisë të mos e përdorë politikisht çështjen e Asociacionit dhe që ta çojë Draftin e Statutit në Kushtetuese, megjë shpreh bindjen se gjykata s’do ta lejojë asnjë Asociacion që është kundërkushtetues. “Mendoj se duhet ta themelohet një Asociacion çfarë edhe është nënshkruar marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit, por ky Asociacion assesi s’bën të dalë jashtë kuadrit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës. Për këtë i kam sugjeruar edhe tani kryeministrin në detyrë që të mos ta përdorë këtë çështje si çështje politike, apo si kauzë elektorale, por si një detyrim shtetëror, ta dërgojë këtë Draft-Statut në Gjykatën Kushtetuese dhe jam i sigurt se Gjykata Kushtetuese s’do ta lejojë asnjë Asociacion që bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës”, ka potencuar Bajrami.

Duke kornizuar vijat e kuqe të Kosovës, të cilat Bajrami thotë se duhet t’i bëjnë publike edhe krerët e shtetit, ai thekson se Kosova në asnjë mënyrë s’bën të pranojë zgjidhje që cenojnë sovranitetin, pavarësinë, karakterin demokratik, unitar dhe kufijtë e Kosovës. Këto vija të kuqe thotë se duhet të mbrohen, qoftë edhe nëse Kosovës do t’i duhet të jetojë e ndëshkuar. “... edhe me kusht që të jetojmë nën sanksione, ne nuk duhet të prekim në bazën e shtetësisë së Kosovës”, shprehet hartuesi i Kushtetutës së Kosovës. Sipas tij, çfarëdo kompromisi që e kërkon bashkësia ndërkombëtare përtej Kushtetutës së Kosovës, do të kishte shumë të panjohura të cilat do t’i

rezikonin bazat e pavarësisë dhe shtetit të Kosovës.

Bajrami ka kritikuar politikën e Kosovës për mënyrën se si e ka menaxhuar aspektin e Asociacionit, duke thënë se ka dështuar të jetë proaktive dhe të draftojë një Draft për t’ua ofruar ndërkombëtarëve si një model të Kosovës.

Profesori thotë se, për fat të keq, tashmë Kosova, edhe me kushtin e themelimit të Asociacionit, s’ka marrë garanci për njohjen nga pesëshja e BE-së dhe as përsheptimin e marrjes së statusit të vendit kandidat të BE-së. “Këtu qëndron ajo padrejtësia që nganjëherë BE-ja ia bën Kosovës, duke i kërkuar gjithmonë kompromise dhe duke mos i dhënë si kundërshtpërblim statusin e barabartë në BE. Jemi vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që ende s’e kemi statusin e kandidatit. Të gjitha shtetet, madje edhe Bosnja që është shtet problematik, e ka marrë një ofertë”, ka thënë Bajrami.

Anëtari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës thotë se Kosova, për përmbysjen e problemit me Serbinë, duhet të kërkojë përsheptim të anëtarësimit në NATO, njohje nga pesëshja e BE-së, praninë në Këshill të Evropës dhe përsheptim të integritit në BE. Bajrami thotë se, derisa Kosova ka këto kërkesa, dhe themelon Asociacionin, ShBA-ja dhe BE-ja, në këmbim të këtyre, duhet të bëjnë presion ndaj Serbisë për ta ndryshuar Kushtetutën dhe ta heqë agresionin kushtetues të saj ndaj Kosovës dhe ta ndalë fushatën diplomatike kundër Kosovës. “Sepse Serbia po vazhdon ta shkelë marrëveshjen Ohër-Bruksel, duke lobuar kundër pavarësisë së Kosovës dhe duke ndikuar te shtetet mosnjohëse që të mos e njohin Kosovën, madje duke i korruptuar disa shtete me të ashtuquajturat

tërheqje të njohjes që kanë bërë”, është shprehur ai.

Pozicioni i Kosovës si shtet, pasqyra në arenën ndërkombëtare dhe fuqia në tavolinë përballë Serbisë, varen shumë edhe nga ndërveprimi që Kosova do të ketë me Administratën e re të ShBA-së, me të cilën qeveria në detyrë e kryeministrin Albin Kurti ka trashëguar probleme dhe inate të vjetra.

Përballë gjithë ndryshimeve gjeopolitike të iniciuara nga ShBA-ja, profesori Arsim Bajrami sugjeron që Kosova duhet të lëvizë dhe të dalë nga status-quoja, megjë gjendja aktuale nuk i konvenon vetëm Kosovës. Ai thotë se Kosova duhet të insistojë në rikthimin e besimit dhe partneritetit me ShBA-në dhe BE-në për mbylljen e dialogut pa cenuar shtetin dhe nisjen e procesit që Kosova të bëhet anëtare fuqiplotë e komunitetit euroatlantik.

Kërkesën që Kosova të dalë nga status-quoja, Bajrami e arsyeton me rrezikun që vendit i kanoset nga Serbia, e cila përmes Rusisë po synon ta mbajë Kosovën shtet me konflikt të ngrirë. Ai shpreson që Kosova të ketë një qeveri të re sa më gjithëpërfshirëse në këto çaste vendimtare. Sipas Bajramit, edhe një qeveri njëvjeçare është e mirëseardhur për t’u marrë me çështjet urgjente dhe shton se, nëse pas kësaj s’arrihet konsensus për zgjedhjen e presidentit, të shkohet për legjitimitet të ri në zgjedhje të reja. “Uroj të kemi një qeveri sa më gjithëpërfshirëse. Jemi në çaste historike: nëse s’kemi një qeveri për katër vjet, na duhet një qeveri për një vit derisa ta zgjedhim presidentin, dhe kjo qeveri t’i marrë detyrat emergjente e urgjente, të sfidohet me sfidat e kohës dhe, nëse pastaj s’arrihet një konsensus për zgjedhjen e presidentit, vendi të legjitimohet me zgjedhje të

reja”, shprehet profesori i Universitetit të Prishtinës.

Bajrami shton se vazhdimi i qasjes së fushatës parazgjedhore ende pa u konstituuar Kuvendi dhe tendenca “që qeverinë e bëj unë dhe askush tjetër”, s’çojnë askund. “S’na duhet një qeveri me 61 vota, por na duhet një qeveri sa më gjithëpërfshirëse, një qeveri që kryen detyrimet e pakryera të Kosovës, rikthen besimin ndërkombëtar, rikthen Kosovën në binarët e partneritetit gjeopolitik dhe strategjik me ShBA-në, BE-në dhe NATO-n dhe hap perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe bën përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të Kosovës”, shprehet ai.

Akademiku sugjeron se lidhshipi aktual e ka për detyrë të jetë pragmatik përballë kohëve që po jetojmë sepse, që nga ardhja e Trumpit, e gjithë bota është e trazuar në pritje të rreshtimeve të reja gjeopolitike. Kur e thotë këtë, Bajrami veçon faktin se sot ShBA-ja s’është më ajo e viteve '90 kur mbronte e drejtonte Kosovën dhe se tashmë Shtëpia e Bardhë e trajton me prioritet interesin e qytetarit amerikan dhe pastaj Evropën. “Kosova duhet ta kuptojë që nuk i ka më miqtë që i kishte në shpalljen e pavarësisë dhe lirisë. Unë vetë kam qenë protagonist i të gjitha proceseve shtetndërtuese nga vitet '90 deri më 2017. S’është ajo kohë kur një shtet i fuqishëm na rrinte mbrapa dhe na udhëhiqte, siç ka qenë ShBA-ja. Sot atje kemi një lidhship të ri që, para së gjithash, ka interesin e qytetarit amerikan, pastaj Evropën. Duhet të jemi të vetëdijshëm që koha s’po punon për ne dhe duhet të tregohemi shumë të mençur dhe të vendosur që ta nxjerrim Kosovën nga kjo situatë që është dhe të hapim një perspektivë euroatlantike për vendin tonë”, sugjeron Bajrami.

Qeveria në detyrë ndan 75 mijë euro për Fondacionin shqiptaro-amerikan

PRISHTINË, 3 PRILL - Qeveria e Republikës së Kosovës në detyrë ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar dy vendime. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se qeveria ka mbështetur

procesin e nisur nga Mbretëria e Bashkuar dhe Franca për trajtimin e përhapjes dhe përdorimit të papërgjegjshëm të aftësive komerciale të ndërhyrjes kibernetike dhe ka ndarë 75 mijë euro për

Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për promovimin e vendit. "Mbështesim procesin e nisur nga Mbretëria e Bashkuar dhe Republika e Francës për trajtimin e përhapjes dhe përdorimit të papërgjegjshëm

të aftësive komerciale të ndërhyrjes kibernetike - 'Procesi Pall Mall'. Janë ndarë 75,000 euro për Fondacionin Shqiptaro-Amerikan, me qëllim të promovimit të vendit", thuhet në njoftim.



VRASJA E POLICIT NË KAÇANIK, HOXHA: JANË INTERVISTUAR DISA PERSONA, PO EKZAMINOHEN DËSHMITË



Prishtinë, 3 prill - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka treguar se institucioni që drejton është duke i marrë të gjitha veprimet e mundshme për ta zbardhur vrasjen e policit Muhamed Lika, e cila ka ndodhur të martën.

Në një prononcim për 'Tëvël', ai ka thënë se policia ka intervistuar disa persona për këtë çështje. Sipas tij, po punohet për ekzaminimin e dëshmitëve. "Është një rast shumë i rëndë që ka ndodhur

para dy netësh. Policia ka dalë menjëherë në vendin e ngjarjes. Ka intervistuar disa persona si dëshmitare të mundshëm. Po punohet për ekzaminimin e dëshmitëve në pjesën teknike. Ende nuk kemi arritur për të verifikuar se a ka ndonjë ndërlidhje mes rastit të vrasjes dhe problemit të mëhershëm", ka deklaruar Hoxha.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, bëri me dije të mërkurën se rreshteri i Policisë së Kosovës, Muhamet Lika, u

vrar nga dy persona në shkallët e ndërtesës ku banonte teksa po kthehej nga puna, dhe se autorët e dyshuar ndodhen në arrati.

Duke folur në një konferencë për medie në Prishtinë, Çerkini tha se autoritetet janë duke punuar për t'i zbardhur motivet dhe arsyet e vrasjes.

Sindikata e Policisë së Kosovës ka dënuar vrasjen e policit, duke thënë se "ky akt i rëndë është një atentat i drejtpërdrejtë ndaj sigurisë publike, ligjit dhe shtetit të Kosovës".

KQZ-ja ÇREGJISTRON DY PARTI

Prishtinë, 3 prill - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka çregjistruar dy parti politike: Partinë Republikane për Ndryshime dhe Shpresën Demokratike për shkak të mospërbushjes së obligimeve.

Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së, Besnik Buzhala, tha se Shpresa Demokratike dhe Partia Republikane për Ndryshime nuk kanë dorëzuar raportet vjetore financiare në këtë zyrë

as pas afatit shtesë prej 15 ditësh. "Duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe në Rregulloren nr. 01/2024 mbi Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, neni 6, partia politike e regjistruar duhet ta dorëzojë formularin për vazhdimin e regjistrimit të saj në formë elektronike ose në formë fizike të nënshkruar jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik.



Meqenëse data 31 mars 2025 ishte festë zyrtare (dita e hënë) sipas nënparagrafit 4 të nenit 81 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, afati për dorëzimin e formularit të regjistrimit është shtyrë deri më 1 prill 2025. Dy partitë politike kane qenë të pezulluara për shkak të mosdorëzimit të raportit vjetor financiar për vitin 2024. Prandaj, duke u bazuar në paragrafin 17 të nenit 15 të Rregullores nr. 06/2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike dhe sipas vendimit të KQZ-së të datës 19.03.2025,

partitë Shpresa Demokratike (me nr. vendimi 01/748-2025) dhe Partia Republikane për Ndryshime (me nr. vendimi 01/748-2025) nuk kanë dorëzuar raportin vjetor financiar në zyrë as pas afatit shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Kur bëhet fjalë që është diçka e rëndësishme, zyra ka komunikim të vazhdueshëm, sidomos kur bëhet fjalë për çregjistrim të partive politike", ka thënë Buzhala.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME FONDACIONIN "BONEVET"

PRISHTINË, 3 PRILL - Universiteti i Prishtinës ka arritur memorandum bashkëpunimi me Fondacionin "Bonevet". Memorandumi është nënshkruar nga rektori Arben Hajrullahu dhe drejtorja menaxhuese e Fondacionit "Bonevet", Flatra Thaqi, ndërsa e pranishme ishte edhe prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, Rozafa Basha. Me memorandum parashihet për zgjedhja nga Universiteti i



Prishtinës i studentëve me performancë të lartë, të cilët do të përgatiten më mirë për tregun e punës në sistemin arsimor të Kosovës, duke qenë pjesë e programit të praktikës profesionale në "Bonevet". Me anë të bashkëpunimit, synohet, gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së arsimit në Kosovë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Fondacionit "Bonevet" në aktivitetet e Universitetit të Prishtinës dhe e studentëve të UP-së në

seminaret dhe trajnimet e këtij fondacioni.

Universiteti dhe Fondacioni do ta krijojnë edhe një sistem të promovimit të përbashkët të ngjarjeve, aktiviteteve dhe rezultateve.

"Bonevet", një institucion edukimi që inkurajon fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit të identifikojnë talentet dhe t'i zhvillojnë aftësitë, tashmë ka nisur bashkëpunimin me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

Gërvalla me ambasadorën e El Salvadorit flasin për fuqizimin e marrëdhënieve mes shteteve

Prishtinë, 3 prill - Zëvendëskryeministria dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur në takim ambasadorën e re jorezidente të El Salvadorit në Kosovë, Rhina Bardi, të cilën e ka uruar për fillimin e mandatit të saj diplomatik.

Gjatë takimit ministria Gërvalla ka thënë se forcimi i lidhjeve dypalëshe ndërmjet Kosovës

dhe El Salvadorit mbetet prioritet, me synimin për të krijuar një partneritet të qëndrueshëm në fusha me interes të ndërsjellë.

Ajo ka riafirmuar rëndësinë e diplomacisë kulturore dhe shkëmbimeve akademike si mjete kyçe për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve.

Në këtë kontekst është thënë se potenciali i Kosovës, veçanërisht

rinia dinamike dhe zhvillimi ekonomik në rritje, janë faktorë kyç për ndërtimin e partneriteteve që kontribuojnë në prosperitetin e përbashkët. Po ashtu, ministria Gërvalla dhe ambasadorja Bardi kanë diskutuar për rëndësinë e krijimit të mundësive të reja për zhvillim dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat të të dyja vendeve.



Trumpi shpall tarifa reciproke ndaj të gjitha vendeve, përfshirë Kosovën

WASHINGTON, 3 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njoftoi të mërkurën se ShBA-ja do të vendosë tarifë bazë prej 10-përqindësh për importet nga të gjitha vendet e botës, përfshirë nga Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ai njoftoi për tarifa më të larta për dhjetëra vende që kanë suficit tregtar me Shtetet e Bashkuara, duke rritur rrezikun për një luftë tregtare dhe rritje të inflacionit.

Ndaj mallrave të importuara nga Kosova është vendosur tarifë prej 10-përqindësh, ndaj atyre nga Shqipëria 10 për qind, atyre nga Serbia 37 për qind, nga Bosnja-Hercegovina 35 për qind dhe nga Maqedonia e Veriut 33 për qind.

Në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi tha se ndaj importeve nga Kina do të vendoset tarifë prej 34-përqindësh, ndaj atyre nga Bashkimi Evropian 20 për qind, nga Koreja e Jugut 25 për qind dhe nga Japonia 24 për qind. Zyrtarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë u thanë gazetarëve se tarifa bazë prej 10 % do të hyjë në fuqi më 5 prill, ndërsa tarifatat reciproke do të hyjnë në fuqi pas një jave, më 9 prill.

Trumpi shpalli emergjencë ekonomike kombëtare për t'i zbatuar tarifatat, të cilat pritet të prodhojnë qindra miliarda dollarë të ardhura vjetore. Ai ka premtuar se vendet e punës në fabrika do të kthehen në Shtetet e Bashkuara si rrjedhojë e këtyre tarifave, por politikantët e tij rrezikojnë ngadalësim të papritur ekonomik pasi konsumatorët dhe bizneset mund të përballen me rritje të mëdha të



çmimeve për automjetet, rrobat dhe mallra të tjera. "Taksapaguesit janë grabitur për më shumë se 50 vjet", tha Trumpi gjatë fjalimit në Shtëpinë e Bardhë, "e kjo nuk do të ndodhë më".

Organizatrat ekonomike në Kosovë thonë se nga viti 2019 ka nisur rritja e eksporteve të përgjithshme të Kosovës në ShBA. Këtë e tregojnë edhe të dhënat e Doganës së Kosovës, sipas të cilave, vlera e tyre në vitin 2019 ishte tre milionë euro, ndërsa tre vjet më vonë arriti në mbi 131 milionë (2022).

Produktet që i eksporton Kosova në ShBA përfshijnë: ushqime, lëngje, tekstil, dyshekë, por edhe prodhime nga druri dhe plastika. Vendosja e tarifave ishte një

nga premtimet kryesore të Trumpit gjatë fushatës së tij. Më herët Trumpi vendosi tarifa të ngjashme prej 25 % mbi importet e automjeteve; tarifa kundër Kinës, Kanadasë dhe Meksikës; si dhe zgjerimin e penaliteteve tregtare mbi çelikon dhe aluminin. Trumpi, gjithashtu, ka vendosur tarifa ndaj vendeve që importojnë naftë nga Venezuela dhe planifikon taksa të veçanta mbi importet e barnave farmaceutike, drurit, bakrit dhe çipave kompjuterikë.

A do ta përshkallëzojnë tarifatat e Trumpit luftën tregtare globale?

Tarifatat e Trumpit tashmë janë përballur me masa hakmarrëse,

dhe njoftimi i së mërkurës mund ta ndezë më tej një luftë tregtare globale.

Si Kanadaja ashtu edhe Kina kanë vendosur tarifa hakmarrëse mbi një sërë produktesh amerikane, ndërsa BE-ja ka deklaruar se do të vendosë një tarifë prej 50 % mbi uiskin amerikan dhe mallra të tjera.

Blloku prej 27 vendesh ka kërcënuar gjithashtu, por ende nuk ka zbatuar një tarifë prej 25 % mbi të gjitha importet nga ShBA-ja.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se Brukseli ka një "plan të fuqishëm" për t'iu kundërpërgjigjur tarifave të reja amerikane.

Tensionet tregtare midis Pekinit dhe Uashingtonit, të

cilat kanë shkëmbyer tarifa që nga shkurti, pritet të përshkallëzohen edhe më tej pas njoftimit të Trumpit të mërkurës.

Megjithatë, presidenti amerikan ka lënë të hapur mundësinë e uljes së tarifave mbi mallrat kineze për të arritur një marrëveshje me kompaninë kineze të TikTok, ByteDance, ndërsa afrohet afati i 5 prillit për shitjen e aplikacionit.

Sipas ligjit amerikan, ByteDance duhej ta shiste pronësinë e TikTok-ut deri më 19 janar ose të përballlej me ndalimin e tij. Megjithatë, Trumpi i dha një afat shtesë prej 75 ditësh.

Çfarë janë tarifatat që i paralajmëron Trumpi?

Tarifatat janë taksa që u ngarkohen mallrave të importuara nga vende të tjera. Ato shihen si një mjet për ta mbrojtur industrinë vendase nga konkurrenca e huaj. Rritja e çmimit të mallrave të importuara synon t'i inkurajojë konsumatorët të blejnë produkte më të lira vendase dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë në rritjen e ekonomisë së tyre. Sipas agjencisë së statistikave të BE-së, Eurostat, rreth 20 vende anëtare të BE-së kanë eksportuar më shumë se importuar nga ShBA-ja në vitin 2023.

Gërxxhaliu: Qëndrimet e FMN-së dhe realiteti ekonomik në Kosovë nuk përputhen

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 PRILL - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxxhaliu, ka thënë se qëndrimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe realiteti ekonomik në Kosovë nuk përputhen. "Nëse FMN-ja nuk po e kupton realitetin ekonomik të Kosovës, atëherë kemi të bëjmë me një institucion të paaftë për ta analizuar situatën. Por nëse këto vlerësime janë të qëllimshme, atëherë pyetja e vërtetë është: Kush po përfiton nga ky mashtrim? Qeveria e Kosovës ka gjetur një aleat të fuqishëm në FMN për t'i legjitimuar politikantët e saj të dështuara ekonomike. Ndërkohë që FMN-ja e lavdëron për 'stabilitetin financiar', realiteti në terren tregon një ekonomi që po lëkundet dhe një popullatë që po varfërohet", ka thënë Gërxxhaliu.

Ai ka theksuar se është koha që qytetarët dhe ekspertët ta sfidojnë këtë narrativë të rreme dhe të kërkojnë politika të

vërteta për zhvillimin ekonomik, e jo thjesht një iluzion stabiliteti të mbështetur në kredi dhe borxh. "Në një kohë kur qytetarët e Kosovës përballen me rritjen e kostos së jetesës, uljen e fuqisë blerëse dhe një treg të brishtë të punës, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) vijon të japë vlerësime pozitive për stabilitetin ekonomik të vendit. Por a është ky një vlerësim real apo një interpretim sipërfaqësor i të dhënave që fshehin problemet thelbësore të ekonomisë? Në raportet e FMN-së Kosova paraqitet si një ekonomi në rritje, me një sektor bankar të qëndrueshëm dhe një rritje të konsiderueshme të kreditimit. Në realitet, kjo rritje bazohet kryesisht në kredi konsumatore, të cilat janë bërë burimi kryesor i financimit për qytetarët që nuk përballojnë më shpenzimet bazë", thotë ai.

Sipas Gërxxhaliut, të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) tregojnë se në vitin 2025 kreditet për konsumatorët arritën mbi 2.1 miliardë euro, një rritje alarmante krahasuar



me vitet e mëparshme. "Kjo nuk është një shenjë e zhvillimit ekonomik, por një tregues i varësisë së qytetarëve dhe bizneseve ndaj borxhit. Në vend që të promovojë politika për t'i nxitur investimet dhe prodhimin vendor, FMN duket se e sheh stabilitetin ekonomik të Kosovës vetëm përmes prizmit të kredive të larta. FMN-ja fokusohet në rritja e sektorit financiar, por injoron indikatorët kyç që përcaktojnë mirëqenien ekonomike të një vendi", është shprehur ai. Ai thotë se eksportet e Kosovës

ranë 1.1 % më 2025, ndërsa importet u rritën 24.7 %, duke thelluar edhe më shumë deficitin tregtar. "Ndërkohë që qeveria dhe FMN flasin për 'stabilitet', ekonomia po bëhet gjithnjë e më e varur nga produktet e jashtme, duke goditur rëndë sektorin prodhues. Pse nuk po investohet në politika që mbështesin prodhimin vendor dhe eksportet? A është ky një dështim i politikave qeveritare, apo një strategji e qartë për ta mbajtur Kosovën në një pozitë të dobët ekonomike? FMN

raporton një inflacion të ulët prej 1.1 % në Kosovë, por realiteti për qytetarët është krejt ndryshe. Çmimet e produkteve bazë, faturat e energjisë dhe qiratë janë rritur ndjeshëm. Konsumi është në rënie, pasi fuqia blerëse e qytetarëve është dobësuar ndjeshëm", ka deklaruar Gërxxhaliu.

Ai ka shtuar se nëse inflacioni është vërtet i ulët, pse qytetarët ndihen gjithnjë e më të varfër? "Kjo tregon një mungesë të qartë të lidhjes midis statistikave të FMN-së dhe realitetit në terren. Një tjetër argument i FMN-së është se shkalla e papunësisë ka rënë. Por kjo rënie nuk vjen si rezultat i krijimit të vendeve të reja të punës, por nga emigrimi masiv i fuqisë punëtore. Mijëra të rinj po largohen çdo vit nga Kosova për shkak të mungesës së mundësive ekonomike. Nëse ky trend vazhdon, atëherë jo vetëm që nuk do të ketë më papunësi, por do të mbesim pa një forcë të re pune për zhvillimin e ardhshëm të vendit", ka thënë ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxxhaliu.

TARIFAT E TRUMP: PËR KINËN 34%, PËR BE-në 20% DHE NJË BAZË PREJ 10% PËR TË GJITHA VENDET

Me një tabelë në dorë, presidenti amerikan Donald Trump zbuloi të mërkurën tarifën e shumëpërfolur për të gjitha vendet duke nisur nga ato më kryesoret.

Ai tregoi se Kina "i ngarkon" Shteteve të Bashkuara një tarifë prej 67 për qind, kështu që Shtetet e Bashkuara do t'i ngarkojnë Kinës një tarifë prej 34 për qind.

Grafiku tregoi gjithashtu se Shtetet e Bashkuara do t'i ngarkojnë Bashkimit Evropian një tarifë 20 për qind, Vietnamit një tarifë 46 për qind, Tajvani 32 për qind, Japonia 24 për qind, India 26 për qind, Koreja e Jugut 25 për qind, Tajlanda 36 për qind.

Trump njoftoi gjithashtu një "tarifë bazë minimale" prej 10 për qind për vendet e tjera për të "ndihmuar në rindërtimin" e ekonomisë amerikane.

Fillimisht ai deklaroi se dita e sotme është "një nga ditët më të rëndësishme" në historinë amerikane, pasi ai pritet të nënshkruajë një urdhër për vendosjen e tarifave reciproke për vende të ndryshme.

"Ne kemi një lajm shumë, shumë të mirë sot", theksoi shefi i Shtëpisë së Bardhë. "Shumë gjëra të mira po ndodhin për vendin tonë".

Ai deklaroi se së shpejti do të nënshkruajë një "urdhër ekzekutiv historik që vendos tarifa reciproke për vendet në mbarë botën".

"Reciproke. Kjo do të thotë se ata na e bëjnë neve dhe ne ua bëjmë atyre. Shumë e thjeshtë. Nuk mund të bëhet më e thjeshtë se kaq", shtoi presidenti Trump.

"Është shpallja jonë e pavarësisë ekonomike", tha Trump duke njoftuar masat e reja.

Presidenti tha se Shtetet e Bashkuara do të përdorin paratë e gjeneruara nga tarifën për të "ulur taksat tona dhe për të paguar borxhin tonë kombëtar".

Sipas tij, 2 prilli do të mbahet mend përgjithmonë si "dita kur industria amerikane rilindi".

"Prej dekadash vendi ynë është plaçkitur, përdhunuar nga kombet e afërta dhe të largëta, si nga aleatët ashtu edhe nga armiqët", vijoi ai.



Trump shpall tarifën 25% për të gjithë prodhuesit e huaj të automjeteve

Në vijim të fjalës së tij, presidenti amerikan Donald Trump deklaroi se kur bëhet fjalë për tregtinë, ndonjëherë "miku (është) më i keq se armiku". Ai thotë se mbi 80 për qind e makinave të prodhuara në

Korenë e Jugut shiten në Korenë e Jugut, dhe mbi 90 për qind e makinave të shitura në Japoni janë prodhuar në Japoni, dhe se makinat e prodhuara në SHBA përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël në ato vende.

"Ford shet shumë pak" në vendet e tjera, thotë Trump, një çekulibër që ka "shkatërruar" industrinë amerikane.

"Kjo është arsyeja pse në mesnatë ne do të vendosim një

tarifë 25 për qind për të gjitha automobilat e prodhimit të huaj", tha Trump. "Këto ditë kanë mbaruar".

Ai vazhdon të kritikojë BE-në dhe vendet aziatike për vendosjen e tarifave ndaj automobilave të prodhuar në SHBA.

Trump shtoi gjithashtu se masat që përdorin vendet e tjera janë gjithashtu "jomonetare".

NGA LIBIA E GADDAFIT, ATJE KU NISI EKSPANSIONI I RUSISË SË VLADIMIR PUTINIT

Gjatë ndërhyrjes perëndimore kundër Gaddafit në vitin 2011, Rusia reagoi me vetëpërmbytje, duke u bashkuar fillimisht me embargon e armëve, e më pas duke u përmbytur në votimin e Këshillit të Sigurimit, çka i hapu rrugën krijimit të një "no-fly zone" dhe, në mënyrë të tërthortë, ndërhyrjes së NATO-s.

Më pas, politika ruse ndaj Libisë u distancua nga ajo perëndimore, duke nisur nga dënimi që i bëri Putini vrasjes pa gjyq të kolonelit. Pas përfundimit të luftës, Rusia zgjodhi rrugën e kujdesit, duke arritur – siç shkruan majori Thomas Arnold nga Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare – që të sigurojë pjesën më të madhe të objektivave të saj taktike dhe strategjike, pa ndërhyrje të mëdha nga Perëndimi.

Kur përplasja ndërmjet Dhomës së Përfaqësuesve në Tobruk dhe Kongresit të Përgjithshëm Kombëtar në Tripoli u kthye në konflikt të hapur, u bë e qartë se Moskë kishte zgjedhur të mbështeste institucionet lindore, por njëkohësisht synonte të mbante të hapura kanalet edhe me Tripolin.

Sipas analistit, sjellja e Rusisë në Libi ishte pjesë e një strategjie më të gjerë, që synonte të ofronte një alternativë ndaj rendit

ndërkombëtar post-sovjetik të udhëhequr nga SHBA, përmes ndërtimit të një sistemi multipolar.

Aksesi në portet "të ngrohta" të Mesdheut ishte një element thelbësor për ruajtjen e përmasës së saj si superfuqi.

Sapo erdhi në pushtet, presidenti Vladimir Putin forcoi marrëdhëniet me Gaddafin, duke fshirë borxhet e Tripolit – më shumë se pesë miliardë dollarë – në këmbim të kontratave për naftën, armët dhe ndërtimin e hekurudhave.

Ai arriti gjithashtu të sigurojë akses në portin e Bengazit, duke vënë në pikëpyetje dominimin e Flotës së Pestë të SHBA, në një zonë që pas Luftës së Ftohtë ishte konsideruar "një liqen i NATO-s".

Por me rënien e Gaddafit, Moskë humbi aksesin në Libi dhe kontratat. Kremlini reagoi duke zgjeruar kapacitetet detare të Forcave të Armatosura ruse, dhe në vitin 2013, Putin shpalli krijimin e një forcë të përhershme detare në Mesdhe, me bazë në portin sirian të Tartus.

Në tetor 2018, intelijenca britanike raportoi hapjen e dy bazave të Grupit Wagner në Bengazi dhe Tobruk.



Kompania private ushtarake Wagner ishte shfaqur për herë të parë në vitin 2014, në Donbas: luftëtarët e saj kishin stërvitje të avancuar dhe ishin të pajisur me armatime moderne.

Sipas The Sun, gjenerali Haftar kishte dhënë miratimin për vendosjen e trupave ruse në Libi me qëllim minimizimin e ndikimit të Bashkimit Evropian, dhe në veçanti të Italisë.

Në nëntor të po atij viti, Haftar udhëtoi drejt Moskës. Në pritje të tij ishin ministri i Mbrojtjes Sergei Shoigu dhe Evgeny Prigozhin, kreu i Wagner-it. U bë e qartë se 1,200 mercenarë të Wagner-it ishin në Libi për të mbështetur

ofensivën ndaj Tripolit. Sipas burimeve amerikane, shpenzimet mbuloheshin nga Emiratat e Bashkuara Arabe.

Mbështetja e Moskës ndaj fushatës së Haftarit ishte e plotë, deri në atë pikë sa përfaqësuesi rus në Këshillin e Sigurimit të OKB-së vuri veton për të bllokuar një rezolutë që dënonte ofensivën ndaj kryeqytetit.

Fitorja më e madhe për Haftarin erdhi në shkurt 2019, me pushtimin e vendburimit të naftës Sharara, më i madhi në Libi, me kapacitet prej 300 mijë fuçi në ditë.



Në atë moment, ai kontrollonte edhe të ashtuquajturën "gjysmëhëna e naftës" në bregdet. Një mercenar i Wagner-it e përshkroi misionin e kompanisë në një intervistë për BBC: "Ekzistojnë tre monumente për Wagner-in. Njëri paraqet një ushtar që mbron një fëmijë me armë në dorë. Por, nëse projektuesi do të ishte i singertë, ai ushtar do të ishte duke mbrojtur një rafineri naftë."

Pas ndërhyrjes së Turqisë në konflikt, ofensiva e Haftarit dështoi dhe u përmbyll me armëpushimin e firmosur më 23 tetor 2020.

Sipas think tank-ut britanik RUSI, kjo "paqe e ftohtë" midis Rusisë dhe Turqisë mund të kthehej në bashkëpunim, me pasoja të padëshiruara për Perëndimin: "Nëse SHBA mbetet e distancuar nga konflikti libian dhe fuqitë evropiane vazhdojnë të kenë agjenda të përçara, Rusia dhe Turqia mund të shohin një mundësi për të marginalizuar fuqitë perëndimore përmes një marrëveshjeje paqeje."

Por ngjarjet morën drejtim tjetër me fillimin e ndërhyrjes ruse në Ukrainë. Më 27 shkurt 2022, tre ditë pas fillimit të "operacionit ushtarak special" në Ukrainë, Turqia ndaloi kalimin e anijeve luftarake ruse nëpër Bosfor dhe Dardanele. Deri në tetor 2023, prania detare ruse në Mesdhe ishte reduktuar në një të pestën e mëparshme.

Në Libi mbeti një pjesë e trupave të Wagner-it, ndërsa shumë mercenarë u zhvendosën në Ukrainë. Kjo u konfirmua nga fotografitë e publikuara në Facebook në prill 2022 nga ushtarë ukrainas, ku shiheshin luftëtarë të vrarë të Wagner-it në Ukrainë lindore, të cilët kishin me vete kartëmonedha libiane dhe të Republikës së Afrikës Qendrore dhe numrin e telefonit të Khalifa Haftarit... / l'espresso – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit



Kombëtarja e Kosovës, dy pozita më lart në renditjen e FIFA-s

Prishtinë, 3 prill - Kombëtarja e Kosovës është ngritur për dy pozita në renditjen më të fundit të FIFA-s të publikuar të enjten. Dardanët tashmë


renditen në pozitën e 97, pas fitoreve në dy ndeshjet e play-off-it të Ligës së Kombeve kundër Islandës. "Ky sukses e ka ndihmuar

ekipin tonë të bëjë një tjetër ngritje të rëndësishme në renditjen botërore, pasi në muajin nëntor Kosova renditej e 99-ta. Pozita e 97

është renditja më e mirë që Kosova e ka arritur që prej pranimit në FIFA dhe UEFA në maj të vitit 2016", ka njoftuar FFK-ja.

Kosova mori pjesë në Kongresin e UEFA-s në Beograd me simbolet shtetërore

Sa iu përket pretendimeve për largimin e flamurit shtetëror të Kosovës gjatë punimeve të Kongresit, Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka theksuar se Kosova ishte e përfaqësuar zyrtarisht me simbolet e saj shtetërore, njësoj si çdo anëtare tjetër e UEFA-s



PRISHTINË, 3 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës ishte pjesë e Kongresit të 49 të UEFA-s, mbajtur në Beograd, ku delegacioni ynë, i kryesuar nga presidenti Agim Ademi dhe u. d. sekretari i përgjithshëm, Markus Weidner, përfaqësoi Kosovën me dinjitet dhe në përputhje të plotë me statusin tonë si anëtare e barabartë në UEFA dhe FIFA. FFK-ja ka njoftuar se në këtë ngjarje të rëndësishme të futbollit evropian, ashtu si çdo federatë tjetër anëtare, Kosova u paraqit me simbolet e saj shtetërore, teksa konfirmoi

edhe një herë përkushtimin për zhvillimin e futbollit dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare. "Deklaratat e pabaza të Federatës së Futbollit të Serbisë, që synuan ta paraqesin pjesëmarrjen tonë si diçka jashtë interesit të futbollit, nuk kanë asnjë bazë dhe vetëm sa dëshmojnë tendencën e vazhdueshme të përzierjes së politikës në sport nga ana e Serbisë. FFK-ja gjithmonë ka përfaqësuar interesat e futbollit të Kosovës dhe do të vazhdojë të punojë për zhvillimin dhe avancimin e lojës së futbollit,

duke mbajtur marrëdhënie të shkëlqyera me institucionet ndërkombëtare. E kuptojmë se prania e delegacionit të Kosovës në kryeqytetin serb, si dhe fakti që flamuri i shtetit tonë valëviti përkrah atyre të shteteve të tjera, vazhdon të jetë i papranueshëm për politikën dhe një pjesë të opinionit në Serbi. Megjithatë, shteti i Kosovës është një realitet i pakthyeshëm dhe sa më shpejt që ta pranojnë këtë, aq më shpejt do të kontribuojnë në normalizimin

e marrëdhënieve sportive dhe shtetërore", është thënë në njoftimin e FFK-së. Sa iu përket pretendimeve për largimin e flamurit shtetëror të Kosovës gjatë punimeve të Kongresit, FFK-ja ka theksuar se Kosova ishte e përfaqësuar zyrtarisht me simbolet e saj shtetërore njësoj si çdo anëtare tjetër e UEFA-s. "Çdo veprim i mundshëm në përfundim të mbledhjes, kur presidenti i FFK-së nuk ishte më në sallë, nuk e ndryshon faktin se Kosova ishte dhe mbetet pjesë e barabartë e këtij organizimi, ashtu siç është në familjen e futbollit evropian dhe botëror. Sigurisht, si gjithmonë, persona të caktuar ndjekin agjenda kundër Kosovës dhe largojnë nga tavolina, madje edhe djegin flamurin e shtetit tonë (siç ndodhi mbrëmë në Beograd nga tifozë të klubeve serbe), por Kosova si shtet është dhe

mbetet një realitet i pakthyeshëm. FFK-ja menjëherë do të paraqesë notë proteste në UEFA dhe institucionet e tjera ndërkombëtare lidhur me këto veprime që janë kundër vlerave që promovon UEFA", ka njoftuar FFK-ja. Më tutje në këtë njoftim theksohet se Kosova u paraqit e barabartë me të gjitha simbolet e saj dhe gjithçka ka shkuar sipas protokollit të UEFA-s deri në pjesën përfundimtare të punimeve. "FFK-ja falënderon UEFA-n për trajtimin e mirë dhe mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e futbollit në Kosovë. Si gjithmonë, ne do të vazhdojmë të punojmë për ta forcuar futbollin tonë dhe për ta përfaqësuar Kosovën me dinjitet në arenën ndërkombëtare", ka njoftuar FFK-ja.

FShF-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Basketbollit për promovimin, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së arbitrimin

TI Ranë, 3 PRILL - Federata e Futbollit dhe Federata e Basketbollit kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim promovimin, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së arbitrimin në të dyja sportet, përkatësisht futbollit dhe basketbollit. Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet shkëmbimi i përvojave, praktikave të mira dhe gjetja e burimeve për të arritur rezultate më pozitive, si dhe për ta rritur nivelin e profesionalizmit të arbitrave. Ky memorandum bashkëpunimi u nënshkrua në ambientet e "Shtëpisë së

Futbollit" dhe të pranishëm ishin presidenti i FShF-së, Armand Duka dhe presidenti i FShB-së, Avni Ponari. Presidenti i FShF-së, Armand Duka, e cilësoi këtë marrëveshje bashkëpunimi shumë të rëndësishme dhe falënderoi presidentin Ponari për gatishmërinë. Presidenti Duka u shpreh i sigurt se kjo marrëveshje do t'u shërbejë të dyja federatave për shkëmbimin e përvojave më të mira dhe për të bërë më shumë për dy sportet më të rëndësishme në Shqipëri. "Jemi në zyrat e Federatës Shqiptare të Futbollit për të



firmosur një marrëveshje shumë të rëndësishme për arbitrimin, bashkë me presidentin e Federatës Shqiptare të Basketbollit, z. Avni Ponari, të cilin e falënderoj dhe i uroj mirëseardhje. Gjithashtu, e falënderoj për gatishmërinë e tij

për këtë marrëveshje. Dy sportet tona, futbollit dhe basketbollit, për mua më të rëndësishmet në vendin tonë, janë sporte të ngjashme sepse janë sporte kolektive dhe kanë elementë që mund t'i bashkojnë. Nëpërmjet këtij memorandumit ne do të bëjmë seminare dhe përgatitje të përbashkëta për arbitrat gjatë dy viteve të ardhshme. Unë jam i sigurt që kjo marrëveshje do t'u shërbejë të dyja federatave dhe të dyja sporteve për shkëmbimin e eksperiencave më të mira që kanë Federata e Basketbollit dhe Federata e Futbollit. Së bashku do të bëjmë akoma më shumë. Një pikë

shumë e rëndësishme e marrëveshjes është aktivizimi i arbitrave vajza dhe gra, si në futboll ashtu edhe në basketboll, mënyra se si duhet t'u qasemi atyre, kushtet që duhet të krijojmë dhe ndihma e tyre për zhvillimin e arbitrimin dhe gjithë sportit të basketbollit e futbollit", tha Duka. Presidenti i FShB-së, Avni Ponari, e cilësoi këtë marrëveshje historike dhe shumë të rëndësishme, pasi do të ndikojë në rritjen e cilësisë së arbitrimin. Gjithashtu, ai e falënderoi presidentin Duka për gjithçka ka bërë për sportin në Shqipëri.


FBK-ja organizon trajnim për gjyqtarë

Prishtinë, 3 prill - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), përkatësisht Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës, organizon trajnim për gjyqtarët e basketbollit. FBK-ja fton të gjithë të

interesuarit në të dyja konkurrencat që të aplikojnë për këtë trajnim. Trajnimi do të bëhet nga 4 deri më 18 prill në zyrat e FBK-së në Prishtinë si dhe në Pejë e Prizren. Trajnimi do të jetë intensiv

dhe përfshin edhe punën praktike. Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte: 1. Të kenë njohuri elementare për lojën e basketbollit (preferohet ish-lojtarë); 2. Të

mos jenë më të vjetër se 24 vjet; 3. Certifikata mjekësore; 4. Preferohet njohja e gjuhës angleze; Paraqitja e kandidatëve mund të bëhet personalisht në zyrat e FBK-së.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Mayhap” L.L.C. pronar Erdon Rasimi, me seli në Gjiilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811890319 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mayhap” D.O.O. Erdon Rasimi Gnjlane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811890319 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Mayhap” L.L.C. Erdon Rasimi with headquarters Gjiilan, has come to the decision to quit its business: 811890319 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerim Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazrek Has Prizren.
- Beqir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazrek Has Prizren.
- Hevzi Latifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës profesionale “Ymer Prizreni” Prizren.
- Hajrush Gashi shpall të pa vlefshme dëftesën e klasës 1 deri 9 të shkollës fillore “Bajram Curri” në Kurushë të Madhe.
- Demokrat Rizanaj shpall të pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gani Çavderbasha” në Prizren.
- Dila Sopjani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zef Lushmarku” Fshati Vilezh.
- Arbër Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Naim J Gashi, B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 811147463 të lëshuar nga ARBK.
- Gani Gashi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 811145219 të lëshuar nga ATK.
- Dulë Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. “Shaban Gola” Lipavec KK Gjakovë.
- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë. Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

